



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 66 datë 30.11.2022

**“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR TË
MIRATUAR ME VKB NR 3, DATË 05.01.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË
VITIT 2022 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2022 –
2024 TË BASHKISË SHKODËR, I NDRYSHUAR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.11.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ i ndryshuar; ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; udhëzimit nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”; ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” VKM nr. 375 datë 1.6.2022 “Një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për zbatim të ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” dhe VKM nr. 480 datë 13.7.2022 “për miratimin e dhënies së granteve për startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve” i ndryshuar; Kontratës së grantit me nr. reference: nr. 4698 prot. datë 11.8.2022 ndërmjet Autoritetit Kontraktor i përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Bashkisë Shkodër për Projektin “Ndërtimi i një qendre rinore për zhvillimin e sipërmarrjes dhe inovacionit” VKB nr. 19, datë 10.05.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”; VKB nr. 3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin “Ndërtimi i një qendre rinore për zhvillimin e sipërmarrjes dhe inovacionit”. **Projektin: “Ndërtimi i një qendre rinore për zhvillimin e sipërmarrjes dhe inovacionit”,** është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime të shpallur nga Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për mbështetjen e Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve. Ky projekt do të përfshihet në

programin P04130 "Mbështetja për zhvillim ekonomik", shuma 7,000,000 Lekë, dhe do të menagjohet me llogari të thesarit.

2. Buxheti total i projektit është 7,777,778 Lekë pa tvsh, nga të cilat financimi i Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes do të jetë në masën 90% të kostove të pranueshme në vlerën 7,000,000 Lekë. Vlera 777,778 leke 10% e fondit total do të jetë bashkëfinancim i Bashkisë Shkodër me anë të burimeve të veta (staf ekzistues).

Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale të patrupëzuarra	Shpenzime kapitale të trupëzuarra
Shuma e bashkëfinancimit nga Bashkia (10 % staf ekzistues)	777,778	666,476	111,301			
Shuma totale e Projektit e financuar nga programi	7,000,000			3,769,590	0	3,230,411
Shuma 2022 - 2023	7,777,778	666,476	111,301	3,769,590	0	3,230,411

3. Vlera e TVSH për projektin në vlerën 1,400,000 do të akordohet në vitin 2023 me rialokimet e buxhetit të vitit 2022
4. Vlera 10% e bashkëfinancimit me staf ekzistues të Bashkisë Shkodër.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për rregullimin e verisjen vendore" i ndryshuar.

KRYETAR

Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratur me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 6.12.2022